

# UDHËZUESI I KARRIERËS SUAJ



# UDHËSUESI I KARRIERËS SUAJ



*Një udhëzues i thjeshtë për t'u përgatitur për  
botën e punës dhe karrierës, për ju tek*

<http://www.duapune.com>

duapune  
.com

Përgatitur nga: **Eljana METE**  
Menaxhere e Proceseve të Rekrutimit & Headhunting,  
pranë DM Consulting Services

Botuar nga: **DM Consulting Services**

## Përmbajtja

Hapi i parë: Njohja e vetvetes.....	5
1.1 Përvoja.....	5
1.2 Interesat.....	5
1.3 Vlerat.....	6
1.4 Aftësitë dhe prirjet.....	6
1.5 Personaliteti.....	7
Hapi i dytë: Konsideroni mundësitë tuaja.....	8
2.1 Studimet.....	8
2.2 Bota e punës.....	9
2.3 Vetëpunësimi.....	9
2.4 Të punuarit dhe të studiuarit jashtë vendit.....	9
2.4.1 Rritja personale.....	9
2.4.2 Rritja në karrierë.....	9
Hapi i tretë: Marrja e një vendimi.....	10
3.1 Rendisni mundësitë tuaja.....	10
3.2 Vlerësimi i karrierës suaj.....	10
3.3 Krahasoni mundësitë dhe bëni vlerësimin.....	11
3.4 Parashikimi i pengesave të mundshme.....	11
3.5 Marrja e një vendimi.....	11
3.6 Përgatitja e një plani rezervë.....	11
Hapi i katërt: Krijoni planin e veprimit.....	12
4.1 Studimet.....	12
4.2 Përvoja vullnetare.....	12
4.3 Ndërtoni rrjetin e kontakteve.....	12
Hapi i pestë: Planifikimi i kërkimit të punës.....	12
5.1 Kërkim pune.....	13
5.1.1 Ndjekja e seminareve.....	13
5.1.2 Bëni kërkime për tregun e punës.....	13
5.1.3 Zhvillimi i aftësive për punësim.....	13
5.1.4 Punëdhënës të ndryshëm.....	13
5.2 Dokumentacioni personal.....	13
5.2.1 CV.....	13
5.2.2 Letra e Motivimit.....	14
5.2.3 Dosja personale e punës.....	14
5.3 Rrjeti i kontakteve.....	14
5.3.1 Aktivizoni kontaktet tuaja në rrjetin tuaj ekzistues.....	14

5.3.2 Zgjeroni rrjetin tuaj të kontakteve: Takoni njerëz të rinj.....	14
5.3.3 Panaire pune, kompani rekrutimi dhe internshipe.....	15
5.4 Teknikat e përgatitjes për një intervistë pune.....	15
5.4.1 Para intervistës.....	15
5.4.2 Gjatë intervistës.....	16
5.4.3 Pas intervistës.....	16
Hapi i gjashtë: Menaxhimi i suksesit në punë.....	17
6.1 Viti i parë në punë.....	17
6.1.1 Njihuni me kulturën e kompanisë.....	17
6.1.2 Dëgjoni sa më shumë.....	17
6.1.3 Kërkoni sugjerime.....	17
6.1.4 Tregoni iniciativë.....	17
6.1.5 Krijoni marrëdhënie të mira në punë.....	17
6.1.6 Rrjeti.....	17
6.1.7 Jini të durueshëm.....	17
6.2 Mirëqenia në vendin e punës.....	17
6.3 Kënaqësia e punës.....	18
6.3.1 Tregoni mënyrën tuaj të punës.....	18
6.3.2 Sfidoni veten.....	18
6.3.3 Tregohuni pozitive.....	18
6.3.4 Ndryshim në Karrierë?.....	18
6.4 Shoqatat profesionale Konferencat.....	19
6.5 Zhvillimi profesional i vazhdueshëm.....	19

## Hyrje

Sa herë ju është dashur të trokisni për të filluar punë për herë të parë ...për të ndryshuar punën ku jeni...apo karrierën tuaj, keni qenë të detyruar të kërkonit me këmbëngulje dhe me efikasitet. Mos u zhgënjeni nëse nuk ju hapen menjëherë dyert e punës, por dhe mos kaloni sa nga një punë në tjetrën...

Përdorni këtë udhëzues për t'u siguruar që lëvizja juaj është e kujdesshme. Mësoni më tepër për veten tuaj, krijoni rrjetin tuaj të kontakteve dhe identifikoni mundësitë tuaja për karrierë...

“Udhëzuesi i karrierës suaj” lindi si nevojë e kërkuar në tregun tonë të dijes dhe punës. Shumë njerëz me status të ndryshëm si studentë apo punonjës në sektorë dhe fusha të ndryshme të tregut të punës dhe dijes kanë nevojë për informacione të shpejta dhe efikase.

Duapune.com ka përgatitur këtë libër si një burim informacioni për ecjen përpara në tregun e punës në Shqipëri. Ai është burimi i parë drejt kërkimit të punës dhe karrierës së vërtetë, duke i shërbyer tregut profesional, tregut të punës së kualifikuar, si dhe zhvillimit të karrierës.

Ndodh që shumë prej nesh janë konfuzë dhe të paqartë për drejtimin që duhet të marrin në jetë, sepse nuk njohin ende plotësisht aftësitë dhe nivelin e tyre të dijes. Udhëzuesi është në këtë rast drejtuesi juaj më i mirë duke ju ndihmuar të njihni vetveten, të gjeni dhe të shqyrtoni mundësitë aktuale që keni, të vendosni për mundësitë që ju paraqiten duke krijuar plane veprimi, t'i planifikoni më së miri ato si dhe të arin deri në menaxhimin e suksesit në fillimin e karrierës tuaj.

Çdo hap dhe pikë e këtij udhëzuesi do të jetë e ilustruar me ushtrimin përkatës apo me informacionin e duhur për të qenë pranë jush sa më i thjeshtë, efikas dhe mbi të gjitha i vlefshëm.





**M**ënyra më e mirë për të hyrë në rrugën e karrierës që ju përshtatet është duke njohur sa më mirë veten tuaj. Kjo do t'ju ndihmojë për të vlerësuar mundësitë tuaja, për të marrë vendime të qarta dhe për të identifikuar mundësitë më me vlerë.

## 1.1 Përvoja

Shqyrtimi i punës suaj të kaluar, i përvojave vullnetare ose arsimore janë një hap i vlefshëm drejt asaj çfarë doni apo nuk doni të bëni në jetë. Shikoni ushtrimin e mëposhtëm, i cili do t'ju lejojë të hidhni dritë jo vetëm mbi arsyet pse jeni përqëndruar në përvoja të caktuara dhe pse i quani ato pozitive, por edhe për arsyet pse nuk keni parapëlqyer përvoja të tjera ose i keni quajtur ato negative.

Ky ushtrim do t'ju ndihmojë të analizoni përvojat e kaluara me aspektet e tyre pozitive si dhe me aspektet e tyre negative. Pasi të keni përfunduar ushtrimin, reflektoni mbi përvojat e punës që do të pasojnë.

Përvojat e mia të punës

### A. Puna e kaluar, përvojat arsimore ose vullnetare

Përgjigjuni pyetjeve, si më poshtë, me hollësi. Merrni kohë të mjaftueshme për të menduar për përvojat tuaja të punës, në mënyrë që të kuptoni se cila është përvoja e punës që ju pëlqen dhe cila është ajo që dëshironi t'i qëndroni larg.

1. Përmendni dy ose tri përvoja pune të kaluara, të cilat ju kanë pëlqyer me të vërtetë.

a. Çfarë aspektesh pozitive kanë pasur këto përvoja pune për ju? (P.sh. referojuni mjedisit të punës, shefit tuaj, kolegëve tuaj dhe detyrave tuaja).

2. Përmendni dy ose tri përvoja pune të kaluara, të cilat nuk ju kanë pëlqyer aspak.

a. Çfarë aspektesh negative kanë pasur këto përvoja pune? (P.sh. referojuni mjedisit të punës, shefit tuaj,

kolegëve tuaj dhe detyrave tuaja).

3. Cili ka qenë kontributi juaj për përvojën e shkuar? (P.sh. referojuni faktit nëse ju kanë përgëzuar për përpjekjet tuaja për një projekt të veçantë apo kur keni ndërmarrë iniciativa të ndryshme).

4. Përmendni cilësira të reja që keni mësuar për veten tuaj gjatë përvojave të punës. (P.sh. mendoni për talentet e fshehura, interesat e reja, etj).

### B. Puna e ardhshme, përvojat arsimore ose vullnetare

1. Çfarë aspektesh shikoni në përvojat tuaja të ardhshme? (P.sh. referojuni mjedisit të punës, shefit tuaj, kolegëve tuaj dhe detyrave tuaja).

2. A ka ndonjë pengesë që mund të ndalojë arritjen e këtyre përvojave të dëshiruara? (P.sh. referojuni financave tuaja, planifikimit të kohës tuaj, përgjegjësive familjare).

3. Çfarë mund të bëni për të rritur shanset tuaja në arritjen e përvojave tuaja të dëshiruara? (P.sh. mendoni për të mirat që do të përfitonin nga puna vullnetare apo kërkimi në internet për mundësi të reja).

## 1.2 Interesat

Interesat tuaja gjenden kryesisht në fushat apo aktivitetet që ju duken interesante dhe që ndonjëherë janë dhe hobet tuaja. Duke kuptuar se cilat janë interesat tuaja, ju do të arrini të përcaktoni objektivat tuaja akademike ose profesionale në të ardhmen në mënyrë që të ndiqni një karrierë të bazuar në këto objektiva. Si për shembull, profesionet në fushën e shkencës mund të jenë me interes për ju, nëse ju dëshironi të punoni në një laborator.

Shikoni ushtrimin e mëposhtëm, nëpërmjet të cilit mund të identifikoni interesat tuaja në lidhje me fushat e punës apo studimeve.

### A. Vlerësimi i interesave të mia

Më poshtë është një listë interesash, e cila mund t'ju ndihmojë të identifikoni interesat tuaja të punës. Zgjidhni vlerësimin që i përshtatet më shumë interesave tuaja.



4 – Shumë interes            3 - Interes  
2 – Pak interes                1 – Pa interes

Komunikimi dhe Marrëdhëniet Ndërpersonale				
4	3	2	1	Të krijoni marrëdhënie me njerëzit
4	3	2	1	Të takoni njerëz të rinj
4	3	2	1	Të shkëmbeni ide
4	3	2	1	Të shprehni duke folur dhe komunikuar
4	3	2	1	Të punoni në Burimet Njerëzore
4	3	2	1	Të merrni pjesë në pritje dhe në mbërme të ndryshme
4	3	2	1	Të drejtoni një ekip ose një klub
4	3	2	1	Të jeni të informuar mbi shumë tema
4	3	2	1	Të ndihmoni njerëzit me iniciativën tuaj personale
4	3	2	1	Të ngushëlloni njerëzit në raste të caktuara
4	3	2	1	Të punoni në fushën e politikës
4	3	2	1	Të aplikoni parime historike
4	3	2	1	Të veproni si zëdhënës për prezantimin në publik të një grupi të caktuar
4	3	2	1	Të organizoni fushatë për mbledhje fondesh
4	3	2	1	Të jepni mësim
4	3	2	1	Të punoni në fushën e gjuhësisë
4	3	2	1	Të komunikoni në telefon
4	3	2	1	Të analizoni mendimet dhe ndjenjat e njerëzve
4	3	2	1	Të punoni në fushën e estetikës
4	3	2	1	Të bindni e të keni influencë tek njerëzit
4	3	2	1	Të drejtoni dhe të organizoni
4	3	2	1	Të flisni në publik

Për më tepër ushtrime për vlerësimin e interesave të ndryshme na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

## B. Përmbledhja e interesave të mia

1. Cilat janë interesat tuaja më të larta?
2. Cilat janë interesat tuaja më të ulëta?

### 1.3 Vlerat

Vlerat tuaja janë cilësitë morale dhe intelektuale që ju përcaktojnë dhe që i japin kuptim jetës suaj. Një karrierë që mbështetet në vlerat tuaja është një nga mënyrat më të mira për të ruajtur kënaqësinë personale dhe motivimin në vendin e punës.

Për të parë nëse perspektivat tuaja të punës janë në përputhje me vlerat tuaja, provoni veten tek ushtrimi i mëposhtëm. Duke bërë këtë ushtrim, ju do të jeni në gjendje të identifikoni atë që ju intereson më shumë.

#### A. Vlerësimi i vlerave të mia

Më poshtë ju paraqitet një listë vlerash, e cila mund t'ju

ndihmojë të identifikoni vlerat tuaja të punës. Sipas shkallës së mëposhtme të vlerësimit qarkoni shkallën e rëndësisë që ju i jepni secilës vlerë. Zgjidhni vlerësimin që i përshtatet më mirë vlerave tuaja.

4 – Shumë e rëndësishme    3 – Mjaftueshëm e rëndësishme  
2 – Pak e rëndësishme        1 – Jo e rëndësishme

4	3	2	1	Aventura Keni përgjegjësi pune të cilat përfshijnë rrezikun.
4	3	2	1	Krijimtari artistike Angazhoheni lirshëm në aktivitete artistike dhe inovative, përdorni imaginatën dhe krijmtarinë
4	3	2	1	Ndryshim dhe shumëllojshmëri Keni përgjegjësi pune që ndryshojnë shpesh në përmbajtje dhe në mjedis.
4	3	2	1	Komuniteti Jetoni në një vend apo qytet ku mund të përfshihe- ni në çështje apo programe lokale.
4	3	2	1	Garat Angazhoheni në aktivitete ku provoni aftësitë tuaja dhe ku ka fitues dhe humbës të vërtetë.
4	3	2	1	Krijmtaria Sillni ide të reja, programe, struktura organizative por jo formate të ngjashme të zhvilluar më pare nga të tjerët.
4	3	2	1	Ritme të shpejta Të punoni në rrethana të tilla ku puna duhet bërë me shpejtësi.
4	3	2	1	Miqësia Zhvillim të marrëdhënieve të ngushta me bashkëpunorët (kolegët).
4	3	2	1	Të ndihmoni të tjerët Të ndihmoni të tjerët drejtpërdrejtë, individualisht ose në grupe të vogla.
4	3	2	1	Të ndihmoni shoqërinë Kontribuoni në përmirësimin e mjedisit (shoqërisë) ku jetoni.

Për më tepër ushtrime për vlerësimin e vlerave të tjera na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

## B. Përmbledhja e vlerave të mia

1. Cilat janë pesë vlerat që ju i quani më të rëndësishme?
2. Cilat janë pesë vlerat që ju i quani më pak të rëndësishme?

### 1.4 Aftësitë dhe prirjet

Prirjet dhe aftësitë tuaja janë zotësia që ju zotëroni ose që e keni përfituar përmes trajnimit dhe përvojës. Sa më shumë të keni këto aftësi për punën që dëshironi, aq më shumë do të donit të përfitoni nga arsimiti, puna, përvojat vullnetare ose projektet personale. Është e rëndësishme që ju të njihni pikat tuaja të forta.

Në ushtrimin e mëposhtëm, rendisni aftësitë dhe prirjet tuaja duke zgjedhur kategoritë e punës që u përshtaten më mirë aftësive tuaja.

## A. Vlerësimi i aftësive dhe i prirjeve të mia

Aftësitë për punësim janë aftësitë e nevojshme për të hyrë, për të qëndruar dhe për të pasur sukses në botën e punës.

Më poshtë ju paraqitet një listë me aftësi, e cila do t'ju ndihmojë të identifikoni aftësitë tuaja në punë. Sipas shkallës së mëposhtme të vlerësimit qarkoni shkallën e rëndësisë që ju i jepni secilës aftësi. Zgjidhni vlerësimin qëu përshtatet më mirë aftësive tuaja.

4 – Shumë i aftë      3 – Mjaftueshëm i aftë  
2 – Pak i aftë      1 – Jo i aftë

Aftësi Menaxheriale				
4	3	2	1	Të administroni Burimet Njerëzore, programet dhe aktivitetet
4	3	2	1	Të përgatisni buxhetin
4	3	2	1	Të klasifikoni informacionin
4	3	2	1	Të koordinoni njerëzit, eventet dhe detyrat
4	3	2	1	Të merrni vendime dhe të përdorni strategji
4	3	2	1	Të delegoni detyrat dhe përgjegjësitë
4	3	2	1	Të vlerësoni performancën, të dhënat dhe rezultatet
4	3	2	1	Të menaxhoni grupin
4	3	2	1	Të menaxhoni personelin dhe aktivitetet
4	3	2	1	Të organizoni personelin dhe eventet
4	3	2	1	Të planifikoni, të caktoni qëllimet dhe buxhetin
4	3	2	1	Të mbani shënime
4	3	2	1	Të mbikëqyrni personelin
4	3	2	1	Të trajtoni persona
4	3	2	1	Të punoni në komisione
4	3	2	1	Të demonstroni aftësi lidhësi
4	3	2	1	Të tregoni vëmendje dhe kujdes
4	3	2	1	Të bëni transaksione financiare
4	3	2	1	Të planifikoni dhe të menaxhoni kohën
4	3	2	1	Të punoni nën presion
4	3	2	1	Të formuloni politika dhe proceduara
4	3	2	1	Të zgjidhni probleme
4	3	2	1	Të keni një memorie të mirë për fakte, shifra dhe njerëz
4	3	2	1	Të ngrini probleme
4	3	2	1	Të krijoni prioritetet

Për më tepër ushtrime për vlerësimin e aftësive dhe prirjeve të tjera na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

## B. Përmbledhja e aftësive dhe e prirjeve të mia

1. Cilat janë aftësitë tuaja më të forta?
2. Cilat janë aftësitë tuaja më pak të zhvilluara?
3. Cilat janë aftësitë që doni të zhvilloni?

## 1.5 Personaliteti

Personaliteti juaj është ai që ju bën të veçantë nga të tjerët. Marrja në konsideratë e interesave, e vlerave dhe e aftësive tuaja zbulon tiparet e karakterit tuaj. Natyrisht që ju e njihni më mirë veten tuaj dhe si rrjedhojë e keni më të lehtë të bëni një zgjidhje të drejtë për karrierën tuaj. Për shembull, një person “intravert” do të shkëlqejë në fusha krejt të ndryshme nga një person “ekstravert” që vepron krejt spontanisht. Ushtrimi i mëposhtëm do t'ju ndihmojë të përshkruani tiparet tuaja të personalitetit si dhe për mundësitë potenciale të karrierës, që lidhen me këto tipare.

## A. Vlerësimi i tipareve të personalitetit tim

Më poshtë ju paraqitet një listë me tipare personaliteti, e cila do t'ju ndihmojë të identifikoni tiparet e personalitetit tuaj. Sipas tabelës së mëposhtme vlerësoni nivelin tuaj të ngjashmërisë me secilin tipar të personalitetit. Zgjidhni vlerësimin që u përshtatet më mirë tipareve të personalitetit tuaj.

4 – Shumë i ngjashëm      3 – Mjaftueshëm i ngjashëm  
2 - Pak i ngjashëm      1 - Jo i ngjashëm

4	3	2	1	Analistik
4	3	2	1	Energjik
4	3	2	1	Autonom
4	3	2	1	I qetë nën presion
4	3	2	1	Kompetitiv
4	3	2	1	Bashkëpunues
4	3	2	1	Konformist
4	3	2	1	indërgjegjshëm
4	3	2	1	Krijues
4	3	2	1	Kritikues
4	3	2	1	I bazuar në fakte
4	3	2	1	I varur
4	3	2	1	Dominues
4	3	2	1	Dramatik
4	3	2	1	Eficient
4	3	2	1	Emocional
4	3	2	1	Empatik
4	3	2	1	Dramatik
4	3	2	1	Eficient
4	3	2	1	Emocional
4	3	2	1	Empatik

## B. Përmbledhja e tipareve të personalitetit tim

Cilat janë pesë tiparet më të mira të personalitetit tuaj që ju mund të përshkruani?





Zbulimi i mundësive profesionale apo të studimit, mund të jetë një proces interesant dhe me shumë vlerë. Prandaj, sa më shumë të kërkoni aq më mirë është për ju. Dalloni dhe organizoni mundësitë duke u bazuar në faktin se sa të vlefshme janë për ju dhe sa do t'ju ndihmojnë të përqëndroheni në marrjen e vendimeve të drejta.

## 2.1 Studimet

Studimet ju ofrojnë njohuri, trajnim, përvojë, zhvillim personal dhe profesional duke ju përgatitur për një karrierë të mundshme në fushën që po studioni. Gjatë marrjes në konsideratë të mundësive tuaja është e rëndësishme të kuptoni se cili është formimi juaj që do t'ju përgatisë për karrierën që dëshironi dhe të siguroheni nëse studimet pasuniversitare plotësuese do t'ju ndihmojnë të siguron punën e ëndërruar.

Disa nga universitetet shtetërore dhe private, të cilat ofrojnë studime pasuniversitare në Shqipëri ku ju mund të drejtoheni janë si më poshtë:

### a. Universitete shtetërore në Shqipëri

Universiteti i Tiranës:	<a href="http://unitir.edu.al">http://unitir.edu.al</a>
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë:	<a href="http://unkorce.edu.al">http://unkorce.edu.al</a>
Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrë:	<a href="http://uogj.edu.al">http://uogj.edu.al</a>
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër:	<a href="http://unishk.edu.al">http://unishk.edu.al</a>
Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan:	<a href="http://uniel.edu.al">http://uniel.edu.al</a>
Universiteti i Vlorës:	<a href="http://univlori.edu.al">http://univlori.edu.al</a>
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës:	<a href="http://uamd.edu.al">http://uamd.edu.al</a>

### b. Universitete private në Shqipëri

University of New York Tirana:	<a href="http://unyt.edu.al">http://unyt.edu.al</a>
Universiteti European i Tiranës:	<a href="http://uet.edu.al">http://uet.edu.al</a>
Universiteti "Luarasi":	<a href="http://luarasi-univ.edu.al">http://luarasi-univ.edu.al</a>
Universiteti "Marin Barleti":	<a href="http://umb.edu.al">http://umb.edu.al</a>
Epoka University, Tiranë:	<a href="http://epoka.edu.al">http://epoka.edu.al</a>
Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë":	<a href="http://unizkm.al">http://unizkm.al</a>
Universiteti "Sevasti & Parashqevi Qiriazi", Tiranë:	<a href="http://uni-qiriazhi.com">http://uni-qiriazhi.com</a>
U.F.O University, Tiranë:	<a href="http://ufouniversity.al">http://ufouniversity.al</a>
Universiteti "Kristal" Tiranë:	<a href="http://kristal.edu.al">http://kristal.edu.al</a>
- Kampusi Fier:	<a href="http://kristal.edu.al/kampus_fier.php">http://kristal.edu.al/kampus_fier.php</a>
- Kampusi Korçë:	<a href="http://kristal.edu.al/kampus_korce.php">http://kristal.edu.al/kampus_korce.php</a>
Universiteti Ndërkombëtar i Arkitekturës dhe Politikave Urbane "Polis":	<a href="http://universitetipolis.edu.al">http://universitetipolis.edu.al</a>
Universiteti Illyria, Tiranë:	<a href="http://uni-illyria.com">http://uni-illyria.com</a>
Universiteti "Justiniani I", Tiranë:	<a href="http://justinianiipare.com">http://justinianiipare.com</a>
Fakulteti i Drejtësisë "Justicia", Tiranë:	<a href="http://universitetijusticia.com">http://universitetijusticia.com</a>
Universiteti Planetar i Tiranës:	<a href="http://universitetiplanetar.com">http://universitetiplanetar.com</a>
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë:	<a href="http://umsh.edu.al">http://umsh.edu.al</a>
Universiteti European për Turizmin:	<a href="http://euft.eu">http://euft.eu</a>

## 2.2 Bota e punës

Bota e punës është e pasur me mundësi të ndryshme. Eksplorojeni atë duke njohur sektorët më premtues profesionalë, tregun e punës dhe tendencat e fundit të tregut të punës, si dhe perspektivat kombëtare të vendeve të punës. Interesohuni që të kontaktoni me punëdhënësit, të cilët janë në kërkim të punonjësve të rinj.

1. Departamenti i Administratës Publike:  
<http://www.pad.gov.al/dopawebpage2/vendevakante.aspx>

2. DM Consulting Services shpk:  
[www.duapune.com](http://www.duapune.com)

Për më shumë informacione mbi agjencitë private të punësimit, klikoni [www.celesi.com](http://www.celesi.com)

### 2.3 Vetëpunësimi

Nisja e një biznesi kërkon kohë dhe hulumtim të tregut konkurrues, si dhe investime të konsiderueshme dhe rrezik. Fillimi i karrierës në biznes është sfidues dhe shpërblyes. Për fillimin e një biznesi kërkojnë aftësi të mira menaxheriale, shumë nisma, udhëheqje dhe vendosmëri. Më poshtë do të gjeni burimet, të cilat do t'ju japin informacionin e nevojshëm:

1. Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR):  
[www.qkr.gov.al/nrc/Application\\_forms.aspx](http://www.qkr.gov.al/nrc/Application_forms.aspx)
2. Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL):  
<http://www.qkl.gov.al/>

### 2.4 Të punuarit dhe të studiuarit jashtë vendit

Zgjedhja për të studiuar apo për të punuar jashtë vendit është bërë një mundësi shumë e përhapur për dy arsye kryesore: rritjen personale dhe rritjen në karrierë.

#### 2.4.1 Rritja personale

Në një kuptim të përgjithshëm, të punuarit ose të studiuarit jashtë vendit është një përvojë që sjell pjekuri personale dhe intelektuale. Jeta në një kulturë të re (pa përmendur mësimin e një gjuhe të dytë) është një mënyrë e jashtëzakonshme për të fituar rritje, pavarësi dhe për të zgjeruar horizontin. Kapërcimi i sfidave të një kulture të re dhe i një mënyre tjetër jetese janë një përvojë shumë e vlefshme për gjithsecilin.

#### 2.4.2 Rritja në karrierë

Përvoja jashtë vendit mund t'i rrisë perspektivat tuaja të punësimit, për shkak se punëdhënësit e dinë që ju keni më shumë njohuri në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare, të paktën në lidhje me vendet ku keni jetuar, si dhe njohuri shumë të mira të gjuhëve të këtyre vendeve. Këto aftësi personale që ju keni përfituar jashtë vendit janë fleksibiliteti, përshtatshmëria dhe aftësia e komunikimit. Për këtë, punëdhënësit e fushave të tregtisë, të marrëdhënieve ndërkombëtare apo të strukturave qeveritare, janë të prirur drejt kandidatëve që kanë punuar apo studiuar jashtë shtetit.


Prandaj nëse parapëlqeni të punoni apo të studioni jashtë

shtetit, duhet të filloni të kërkoni dhe të hulumtoni për burimet që ju ofrojnë këto mundësi, pasi ky planifikim si proces kërkon kohën e vet. Për t'u informuar për programe të ndryshme të shkëmbimit universitar ose pasuniversitar për shtetasit shqiptarë vizitoni faqet e internetit të këtyre programeve.

Kontaktoni Education USA Albania për të mësuar më shumë për gamën e plotë dhe mundësitë financiare për studime dhe bursa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke vizituar [www.educationUSA.state.gov](http://www.educationUSA.state.gov)

- Rhodes College:	<a href="http://rhodes.eduadmissions/68.asp">http://rhodes.eduadmissions/68.asp</a>
- Roger Williams University:	<a href="http://rwu.edu">http://rwu.edu</a>
- Yale College:	<a href="http://yale.edu/sfas/finaid/prospective-students">http://yale.edu/sfas/finaid/prospective-students</a>
- University of Richmond Scholarships:	<a href="http://financialaid.richmond.edu/prospective/scholarships.html">http://financialaid.richmond.edu/prospective/scholarships.html</a>
- Master's degree program at the University of South Florida:	<a href="http://www.cas.usf.edu/humanities/grad.html">www.cas.usf.edu/humanities/grad.html</a>
- Fulbright Student Program:	<a href="http://www.fulbright.state.gov">www.fulbright.state.gov</a> <a href="http://www.ii.org/fulbright">www.ii.org/fulbright</a> <a href="http://www.tirana.usembassy.gov">www.tirana.usembassy.gov</a>
- Hubert H. Humphrey Program:	<a href="http://www.iie.org/pgms">www.iie.org/pgms</a> <a href="http://www.tirana.usembassy.gov">www.tirana.usembassy.gov</a>
- Për studime në Gjermani "Deutscher Akademischer Austausch Dienst," (DAAD):	<a href="http://www.daad-al.org">www.daad-al.org</a>
- Për studime në UK:	<a href="mailto:info@kipea.co.uk">info@kipea.co.uk</a> <a href="http://www.kipea.co.uk">www.kipea.co.uk</a>
- Për studime në Francë:	<a href="http://www.campus-france.org/en/index.htm">http://www.campus-france.org/en/index.htm</a>
- Istituto Italiano di Cultura:	<a href="http://www.iicitirana.esteri.it/IIC_Tirana">http://www.iicitirana.esteri.it/IIC_Tirana</a>

# Hapi i Tretë: Marrja e një Vendimi



Për më tepër na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

## 3.2 Vlerësimi i karrierës suaj

Për të zgjedhur fushën e veprimit dhe për të shqyrtuar më me efikasitet të gjitha mundësitë që ju ofrohen, përpiquni të bëni krahasime midis mundësive që ju paraqiten. Ushtrimi i mëposhtëm do t'ju mësojë se si të mund të vendosni kriteret e duhura për të bërë vlerësime të sakta, me qëllim që të arrini në një vendim të sigurt. Nëse ende nuk keni vendosur apo jeni të paqartë, rishikoni dhe një herë hapin e parë të këtij udhëzuesi “Njohja e vetvetes”.

**M**arrja e një vendimi të vlefshëm del si rezultat i një vlerësimi që duhet bërë duke krahasuar mundësitë dhe duke marrë parasysh personalitetin, vlerat, interesat dhe pritshmëritë tuaja. Qëllimi përfundimtar për marrjen e një vendimi është të zgjedhësh mundësitë që ju ofrojnë kënaqësi dhe sukses. Parashikoni sfidat e mundshme dhe pengesat që mund t'ju dalin gjatë rrugës dhe përshtatuni me ato.

Krijoni kriteret tuaja të vlerësimit

Më poshtë ju paraqitet tabela vertikale, të cilën mund ta përdorni për të shënuar kriteret e vlerësimit tuaj. Mos hezitoni të përdorin tabelën dhe ta modifikoni sipas nevojave tuaja.

### 3.1 Rendisni mundësitë tuaja

Para se të merrni një vendim, sigurohuni që keni marrë në konsideratë dhe keni shqyrtuar mirë të gjitha mundësitë tuaja. Shkruani me kujdes të gjitha mundësitë që keni marrë parasysh, si dhe gjithë informacionin e duhur që keni mbledhur për to. Ushtrimi i mëposhtëm do t'ju lejojë të shqyrtoni të gjitha mundësitë tuaja si dhe në të njëjtën kohë të vlerësoni potencialin e tyre.

Rendisni mundësitë tuaja

Më poshtë ju paraqitet tabela vertikale, të cilën mund ta përdorni për të renditur mundësitë tuaja. Mos hezitoni të përdorni tabelën dhe ta modifikoni sipas nevojave tuaja.

Tabela Vertikale

	Mundësitë e Mia	Përvoja përkatëse	Informacioni përkatës
1			
2			
3			

Tabela Vertikale

Kriteret e mia të vlerësimit	Mundësia 1:	Mundësia 2:	Mundësia 3:
Edukimi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shpenzime jetese	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Të ardhura	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pozicioni gjografik	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ndikimi mbi familjen dhe miqtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Potenciali i kënaqësisë dhe i mirëqënies	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Kontributi për objektivat profesionale dhe personale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Koha e investimeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sfidat dhe stresi	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Të tjera:	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Për më tepër tabela na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

### 3.3 Krahasoni mundësitë dhe bëni vlerësimin

Pasi të keni vendosur kriteret e vlerësimit tek të cilat do të bazoheni, mund të zhvilloni një sistem, të cilin mund ta përdorni për të vlerësuar dhe krahasuar mundësitë tuaja. Për shembull, ju mund të përdorni një sistem të tillë ku të rreshtoni mundësitë “pro” dhe “kundra” dhe arsyet pse jeni të interesuar për secilën mundësi. Ka shumë mënyra për të kryer këtë detyrë, por e rëndësishme është që ju të arrini të qartësoni mendimet dhe të analizoni sa më saktë mundësitë. Nëpërmjet ushtrimit të mëposhtëm, ju mund të zbuloni mundësitë më të mira.

Vlerësoni dhe krahasoni mundësitë tuaja

Më poshtë ju paraqitet tabela horizontale, të cilën mund ta përdorni për të vlerësuar dhe krahasuar mundësitë tuaja. Mos hezitoni të përdorin tabelën dhe ta modifikoni sipas nevojave tuaja.

Tabela Horizontale

<b>Mundësia 1:</b>
Pro:
Kundra:
Arsyet:
<b>Mundësia 2:</b>
Pro:
Kundra:
Arsyet:
<b>Mundësia 3:</b>
Pro:
Kundra:
Arsyet:

Për më tepër na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

### 3.4 Parashikimi i pengesave të mundshme

Kur merrni një vendim të rëndësishëm, shpesh ndodh që të hasni paqartësi dhe ankth që krijohen nga kjo gjendje.

Për t’u fokusuar në qëllimin tuaj duhet të jeni të motivuar dhe të përfitonit; për këtë zbatoni ushtrimin si më poshtë. Shkruani përbri çdo mundësie pengesat që mund të hasni, në këtë mënyrë ju mund të përcaktoni se si t’i kaloni dhe të kuptoni se si mund të keni sukses.

Parashikimi i pengesave të mundshme

Më poshtë ju paraqitet tabela vertikale, të cilën mund ta përdorni për të parashikuar pengesa të mundshme. Mos hezitoni të përdorin tabelën dhe ta modifikoni sipas nevojave tuaja.

Tabela Vertikale

	<b>Mundësitë e Mia</b>	<b>Pengesa të mundshme</b>	<b>Zgjidhje të mundshme</b>
1			
2			
3			

Për më tepër na ndiqni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

### 3.5 Marrja e një vendimi

Pasi të keni diktuar, vlerësuar dhe krahasuar të gjitha mundësitë tuaja dhe pasi të keni parashikuar pengesat që mund të dalin, atëherë duhet të kuptoni se cilat mundësi ju përshtaten më shumë juve. Megjithatë, nëse marrja e një vendimi ende duket e vështirë për ju, për këtë ju udhëzojmë t’u referoheni përsëri hapave 1 dhe 2 “Njohja e vetvetes” dhe “Konsideroni mundësitë tuaja” për të shqyrtuar arritjet tuaja nëpërmjet ushtrimeve të tyre në mënyrë që të përcaktoni fushën e kërkimit më tej.

### 3.6 Përgatitja e një plani rezervë

Rrethanat e paparashikuara mund të pengojnë edhe planin më të mirëpërgatitur. Nëse zgjedhja juaj e parë nuk realizohet për shkak të një interviste jo të mirë, të një aplikimi të refuzuar etj, të pasurit të një plani B, C edhe D do të ishte zgjidhja më e mirë, sepse do t’ju jepte shtysë ndoshta jo drejtpërdrejt, por edhe tërthorazi të përmirësoni shanset tuaja dhe të arrini qëllimin tuaj fillestar.





dhe fushën ku dëshironi të punoni:

1. Studentë në Sipërmarrje të Lirë (SIFE):  
[www.sifealbania.org](http://www.sifealbania.org)
2. Aleanca Rinore Shqiptare (Albanian Youth Alliance):  
<http://orgs.tigweb.org/albanian-youth-alliance>
3. Këshilli Rinor Shqiptar:  
[http://seeyn.org/Albanian\\_Youth\\_Council.html](http://seeyn.org/Albanian_Youth_Council.html)
4. Bashkia e Tiranës:  
<http://tirana.gov.al/?cid=1,82>
5. CH.H.W shoqatë për ndihmë që ofron praktikë për studentët dhe vullnetarizëm:  
<http://chwev.dyndns.org/albanienhilfe/>

**Nj**ë plan veprimi ndihmon për të përcaktuar qëllimin tuaj, si dhe për të arritur hapat e nevojshme duke u bërë ballë sfidave që mund të hasni. Kjo do të jetë e dobishme për planifikimin dhe vazhdimin e studimeve tuaja, për të kërkuar punë apo për të vazhduar zhvillimin tuaj personal. Për secilën nga mundësitë tuaja specifikoni qëllimin, hapat e nevojshme dhe sfidat e mundshme. Rishikimi herë pas here i planit tuaj të veprimit ju ndihmon të përparoni.

## 4.1 Studimet

- Planifikimi i studimeve tuaja

Para se të planifikoni rrugën tuaj të karrierës, ju duhet të planifikoni drejtimin e studimeve tuaja. Para se të filloni me këtë proces ju nevojitet të merrni informacione të nevojshme për të krijuar baza të shëndosha.

- Para se të regjistroheni në një program studimi, duhet të planifikoni edhe anën tuaj financiare.

- Planifikimi i studimeve tuaja pasuniversitare

Para se të filloni të ndiqni studimet pasuniversitare, ju duhet të bëni kërkime. Për të ndërtuar një plan të mirë veprimi, duhet të zbuloni programet që janë në dispozicion të kërkesave tuaja dhe të kontaktoni profesionistë të fushave përkatëse për të cilat ju keni interes. Për informacione më të hollësishme shikoni hapin e dytë “Konsideroni mundësitë tuaja”.

## 4.2 Përvoja vullnetare

Vullnetarizmi është një mënyrë e shkëlqyer për të fituar përvojë profesionale, pasi kjo është një mundësi për rritjen personale dhe ndihmesë për zhvillimin e komunitetit. Ajo tregon gjithashtu edhe cilësi të tjera si: maturi dhe përgjegjësi. Vini re se disa fusha të arsimit ose të karrierës kërkojnë përfshirjen ose fillimin e përvojës suaj me vullnetarizëm në komunitet, siç është p.sh. rasti i mjekësisë dhe i mësimdhënies. Punëdhënësit në përgjithësi shprehen se çdo përvojë vullnetarizmi rrit mundësitë tuaja në çdo fushë të karrierës, pasi përforcon vlerat tuaja personale dhe zhvillon aftësitë tuaja për punë. Më poshtë ju paraqiten burime tek të cilat mund të kërkonte punë vullnetare duke zgjedhur

## 4.3 Ndërtoni rrjetin e kontakteve

Çdo ditë ju takoni njerëz që ofrojnë informacione të ndryshme, të cilat mund t’ju udhëzojnë në rrugën tuaj të karrierës. Duhet të dini si t’i ruani këto kontakte me familjarët tuaj, shokët e klasës, kolegët, punëdhënësit, profesorët apo profesionistë të tjerë. Sigurohuni që të merrni në rrjetin tuaj të kontakteve dhe të takimeve sa më shumë informacione duke përfutur nga të gjitha situatat.





Duapune - Vende të lira pune  
Faqe 1 nga 2 / 380: 1 - 25

№ Vendi i listës pune	Profesione	Kompania	Data e fillimit	Data e mbarimit
21906	HE Head of Unit	Insular	02-09-2010	15-09-2010
21904	Agjent marketingu	Marketing Service	17-07-2010	18-09-2010
21902	Director Kreativ	Disuper	18-09-2010	18-09-2010
21917	Financier	Ekonomet	02-09-2010	20-09-2010
21918	Magjistër	OR	02-09-2010	20-09-2010
21919	specialist marketing	OR	02-09-2010	20-09-2010
21920	PRISQENI I Burimeve Njësore	OR	02-09-2010	21-09-2010
21922	Funditor	OR	02-09-2010	21-09-2010



**P**ërdorimi me efektivitet i mjeteve dhe i strategjive për kërkimin e punës do të rrisë aftësinë tuaj për të ecur me sukses në tregun e punës. Mbledhja e informacionit përkatës, ndërtimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe krijimi i rrjetit të kontakteve ju përgatisin që të keni përparësi në intervista pune.

## 5.1 Kërkim pune

### 5.1.1 Ndjekja e seminareve

Duke marrë pjesë në seminare ju mund të merrni këshilla në lidhje me tema të ndryshme, të tilla si:

- Zhvillimi i karrierës
- Teknikat dhe mjetet e kërkimit të punës
- Rrjeti i kontakteve

### 5.1.2 Bëni kërkime për tregun e punës

Për të studiuar tregun e punës duhet të keni kohë, durim si dhe të bëni planifikimin e duhur. Kërkimi i punës suaj mund të fillojë dhe nga adresa jonë duapune.com, por është shumë e rëndësishme që ju të keni rrjetin tuaj të kontakteve, i cili mund t'ju ndihmojë për të marrë pjesë në intervista pune. Duke vepruar në këtë mënyrë, ju do të keni më shumë dyer të hapura për karrierën tuaj.

- Nëse jeni duke kërkuar për një punë me kohë të plotë merrni pjesë në panairë pune që organizohen nga universitetet e ndryshme ose ministria e punës.
- Konsultohuni me zyrat e karrierës në universitetin tuaj. Në mungesë të një zyre karriere, ju mund të përfitonit nga shërbimi i kompanisë DM Consulting Services, e cila ju ofron ide dhe këshilla rreth karrierës suaj.

### 5.1.3 Zhvillimi i aftësive për punësim

Aftësia për punësim është "aftësia që ju nevojitet për të hyrë, për të qëndruar dhe për të përparuar në botën e punës, duke punuar vetëm ose si pjesë e një ekipi". Punëdhënësit kërkojnë individë, të cilët kanë zhvilluar aftësitë e punësimit përmes përvojave të kaluara, sepse këto aftësi konsiderohen "të transferueshme".

Për të qenë të sigurtë se keni aftësitë dhe përvojat për një fushë të veçantë profesionale, është e rëndësishme që të

takoni punëdhënësit dhe njerëz të fushave profesionale që ju interesojnë, nëpërmjet panairëve të punës ose zyrave të rekrutimit. Ja disa nga aftësitë që janë të dëshirueshme në punë të caktuara:

- Përshtatshmëri dhe fleksibilitet
- Aftësitë analitike
- Autonomi
- Komunikim (me gojë dhe me shkrim)
- Aftësi informatike
- Krijimtari
- Aftësitë në vendimmarrje
- Ndershmëri
- Aftësi drejtuese dhe menaxheriale
- Aftësi të dëgjuari
- Menaxhim dhe organizim i informacioneve
- Aftësi negociimi
- Pjesëmarrje në projekte dhe detyra të ndryshme
- Sjellje dhe qëndrim pozitiv
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve
- Siguri
- Ndjenjë përgjegjësie
- Etikë në punë
- Punë në ekip
- Siguri në punë

### 5.1.4 Punëdhënësit të ndryshëm:

1. Sektori publik
2. Sektori privat
3. Institucione jofitimprurëse, joqeveritare ose sektori vullnetar.

## 5.2 Dokumentacioni personal

### 5.2.1 CV

CV-ja është një mjet marketingu. Përdoreni me mençuri për të promovuar veten si një punonjës i mundshëm, duke shfaqur aftësitë, prirjet, historinë e punës dhe interesat tuaja. Nuk ka një mënyrë të caktuar për organizimin e informacioneve në CV-në tuaj. Por është e rëndësishme që të përfshini informacione që nxjerrin në pah aftësitë tuaja më të mira. Objektivi kryesor i një CV-je është të siguronit një intervistë pune. CV-ja juaj duhet përshtatur për çdo pozicion pune që ju aplikoni në mënyrë që të tregoni potencialin tuaj me shembuj bindës dhe konkretë.

Më poshtë janë disa këshilla për të mbajtur mend, ndërsa filloni të shkruani CV tuaj:

- Të dhënat personale
- Objektivat e karrierës
- Përmbledhje e kualifikimeve
- Lista e çmimeve, e arritjeve ose e publikimeve
- Përvoja e punës
- Aftësitë profesionale
- Përfshirja në komunitet dhe përvojë vullnetare

- Edukimi
- Interesat personale
- Referencat

Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore.



Kujdes! Kontrolloni CV-në përpara se ta dërgoni tek punëdhënësi. Edhe gabimet më të papërfillshme mund t'ia humbin vlerën CV-së dhe ju do të dukeni të pakujdesshëm. Punëdhënësi mund të mendojë se ju do ta trajtoni punën tuaj të re me të njëjtën pakujdesi që keni treguar në CV-në tuaj.

Për të gjetur disa shembuj CV-je klikoni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

### 5.2.2 Letra e Motivimit

Letra e motivimit është një mundësi për të shtuar informacione personale tek CV-ja tuaj. Shumë kandidatë aplikojnë për të njëjtin pozicion pune dhe letra e motivimit ka për qëllim që ju të dilni më në pah në krahasim me kandidatët e tjerë.

Më poshtë janë disa këshilla për t'u mbajtur mend, ndërsa filloni të shkruani letrën e motivimit:

- Në paragrafin e parë qartësoni titullin e pozicionit ku ju po aplikoni, si keni dëgjuar për atë pozicion dhe pse mendoni se jeni personi i duhur për atë punë.
  - Në paragrafin e dytë shpjegoni arsyen pse jeni të interesuar në këtë kompani, si dhe mundohuni të ilustroni se si aftësitë, njohuritë dhe cilësitë tuaj personale përputhen me vlerat dhe nevojat e kompanisë në fjalë.
  - Në paragrafin e tretë jepni informacion të shkurtër rreth edukimit, përvojës së punës, aftësive, arritjeve, karakteristike personale dhe aspiratave të karrierës. Demonstroni me shembuj konkretë dhe të qartë se si ju mund të jeni të vlefshëm për kompaninë në fjalë.
  - Në paragrafin e katërt kërkoni që ata të kontaktojnë me ju, brenda mundësive të tyre ose mund dhe të shkruani për një kohë të veçantë kur ju mund t'i telefononi. Sigurohuni që të dhënat tuaja të kontaktit të jenë sa më të sakta dhe të lehta për t'u gjetur. Mund të bëni një kërkesë për intervistë dhe mos harroni të falenderoni lexuesin për kohën e leximit të letrës suaj.
  - Mos harroni dhe paragrafin e mbylljes së letrës me emrin dhe mbiemrin tuaj.
- Për të gjetur disa shembuj letrash motivimi klikoni në seksionin më të zgjeruar të këtij udhëzuesi në [duapune.com](http://duapune.com)

### 5.2.3 Dosja personale e punës

Dosja personale e punës është një përzgjedhje e dokumentave rreth shkollimit dhe historisë tuaj profesionale. Ajo mund të jetë veçanërisht e dobishme kur ju duhet:

- të siguroni dëshmi për njohuritë dhe aftësitë tuaja gjatë një interviste.
- të planifikoni zhvillimin e karrierës suaj.
- të tregoni talent ose gatishmëri për avancim në karrierën tuaj.

Më poshtë janë disa këshilla për t'u mbajtur mend, ndërsa grumbulloni informacione në dosjen tuaj:

- Përmbajtja.
- CV e rifreskuar.
- Kopje të certifikatave, diplomave ose trajnimeve.
- Letra reference nga punëdhënësit, profesorët, trajnuesit, shoqatat e komunitetit, menaxherët e projekteve ose nga organizata vullnetare.
- Shpërblimet ose bursa të ndryshme.
- Një përmbledhje të projekteve dhe të prezantimeve të kryera gjatë viteve akademike.
- Shkrime, nëse jeni autor publikimesh nëpër gazeta ose revista.
- Evidenca të aktiviteteve në të cilat keni qenë të përfshirë, si për shembull në skuadra sportive, në shoqata studentore, shërbime komunitare dhe punë vullnetare.
- Rezultatet e testeve psikometrike.

### 5.3 Rrjeti i kontakteve

#### 5.3.1 Aktivizoni kontaktet tuaja në rrjetin tuaj ekzistues

Rreth 80% e punëve nuk reklamohen por bëhen të njohura nëpërmjet rrjetit jozyrtar. Mënyra më e mirë për të qenë të pranishëm në këtë treg pune të fshehur është të mbani kontakte me rrjetin tuaj.

Komunikoni me ish-punëdhënësit, kolegët dhe profesorët tuaj. Njoftojini ata që së shpejti do të diplomoheni dhe kështu që do të duhet t'i pyesni për mundësi punësimi.

#### 5.3.2 Zgjeroni rrjetin tuaj të kontakteve: Takoni njerëz të rinj

- Bëni punë kërkimore rreth organizatave dhe kompanive ku do të donit të punonit në të ardhmen. Kërkoni numra të telefonit ose adresa interneti për të pasur mundësinë të kontaktoni me kompaninë.
- Merrni pjesë në konferenca të ndryshme për të qenë sa më afër me ekspertë të cilët ndajnë njohuritë dhe praktikatat më të mira në fushën tuaj.
- Bëni kërkime personalisht ose duke telefonuar, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:
  - Filloni me prezantimin e vetes tuaj.
  - Nëse jeni duke folur me receptionistin, shpjegojini arsyen e telefonatës suaj dhe përcaktoni interesin në sektorin që jeni të interesuar. Pyesni për emrin dhe kontaktin e personit që mund t'ju ndihmojë.
  - Nëse ju telefononi, sepse po kërkoni punë, duhet të jeni sa më të sinqertë dhe të thoni se jeni duke eksploruar mundësitë e punësimit në fushën tuaj brenda asaj kompanie.
  - Nëse keni kontaktuar një punonjës, i cili ka mjaftueshëm informacion rreth kompanisë dhe sektorit që ju jeni të interesuar, prezantoni veten dhe tregoni se doni të mblidhni sa më shumë informacion në lidhje me kompaninë.

Pyeteni atë nëse është e mundur një takim për mbledhjen e informacionit me telefon apo takim personal.



### 5.3.3 Panairë pune, kompani rekrutimi dhe internshipe

Universitetet ofrojnë mundësi që studentët e viteve të fundit të marrin pjesë në panairë pune. Ngjarje të tilla janë një mundësi e shkëlqyer për të zgjeruar rrjetin tuaj, dmth për të krijuar kontakte të reja me profesionistë në fushën tuaj të interesit.

a. Panairët e karrierës ju japin mundësi për t'u takuar me punëdhënësit e të gjithë sektorëve në industri si dhe për të marrë informacione mbi kompanitë e tyre, mundësitë e punësimit dhe proceset e rekrutimit. Për të pasur një përfitim të plotë në karrierën tuaj ne mund t'ju ndihmojmë me rekomandimet e mëposhtme:

- Merrni listën e kompanive pjesëmarrëse dhe mësoni më shumë rreth misionit, linjave të prodhimit dhe shërbimeve të tyre.
- Listoni gjithë kompanitë ku ju jeni të interesuar dhe shkruani pyetjet që do të dëshironi t'u bënit atyre.
- Mundohuni të promovoni veten, aftësitë dhe talentin tuaj.
- Freskoni dhe përshtasni CV-në tuaj për të plotësuar nevojat e punëdhënësve.
- Shkëmbeni kontaktet.
- Mbani shënime mbi bisedat me punëdhënësit.
- Ndiqni këto kontakte të reja.

b. Kompanitë e rekrutimit janë një risi në tregun shqiptar, por me premisa në të ardhmen. Kompani të tilla nuk janë shumë të përhapura, por ndër kompanitë më aktive në treg është DM Consulting, e cila ofron shërbimin e rekrutimit në tregun shqiptar duke qenë sa më afër punëdhënësit dhe punëkërkuessit. 100% të kushtuar për punësim duke njoftuar në kohë reale për çdo vend të lirë pune të postuar.

c. Internshipe/Praktika. Çfarë është internship-i dhe pse na duhet? Internshipi është një përvojë pune pa pagesë që ju ndihmon për të eksploruar ose fituar aftësitë që ju duhen për të hyrë më thellësisht në fushën tuaj të interesit/punës. Praktikant zakonisht janë afatshkurtra dhe studentët nuk paguhen. Por mungesa e pagës nuk krahasohet me vlerën dhe përvojën që mund të merrni pasi mbaroni praktikën.

Internshipi është i rëndësishëm sepse:

- Fitoni përvojë pune. Kjo është një nga arsyet pse shumica e studentëve aplikojnë për praktikë gjatë studimeve. Në këtë mënyrë ata ndërtojnë përvojën e punës që kanë nevojë në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur pas diplomimit në tregun e punës.
- Bota reale ka një ndryshim rrënjësor me leksionet dhe teoritë gjatë studimeve tuaja. Duke pasur përvojën e një praktike ju mund të shihni se si merren vendimet për projekte të ndryshme dhe se si është puna me të vërtetë.
- Ju ndihmon të njihni veten tuaj dhe kompaninë për të cilën jeni të interesuar. Shumë prej nesh kanë ëndrra për karrierën: të bëhen menaxherë, liderë ose inxhinierë, por nuk mund të jeni 100% të sigurtë sesa të aftë jeni për atë pozicion pune, por duke pasur përvojën e praktikës mund të zbuloni veten tuaj dhe të arrini të kuptoni se çfarë do të ishte e përshtatshme për karrierën tuaj të ardhshme.
- Dhe së fundmi, është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar kontakte të reja profesionale.

### 5.4 Teknikat e përgatitjes për një intervistë pune



#### 5.4.1 Para intervistës

Keni një intervistë? Tani është koha që të përgatiteni për procesin e shqyrtimit dhe të punësimit. Intervistat mund të kryhen vetëm me një person, me panel/ komision, me telefonatë ose me video-konferencë. Më poshtë do të gjeni disa sugjerime që vlejnjë për të gjitha llojet e intervistave.

- Analizoni me kujdes përshkrimin e punës. Krahasoni aftësitë dhe përvojat tuaja me kërkesat e punës.
- Bëni kërkime rreth kompanisë. Duhet të kuptoni misionin, objektivat dhe kulturën e kompanisë.
- Kërkoni për vendodhjen e intervistës suaj dhe informohuni nëse do të ketë ndonjë test.
- Pyesni për emrin dhe titullin e njerëzve që kryesojnë intervistën.
- Parashikoni pyetje të mundshme në intervistën tuaj dhe përgatisni përgjigjet tuaja. Ekzistojnë tri lloje pyetjesh: pyetje të përgjithshme, pyetje të sjelljes dhe pyetje të situatës.

Pyetjet e përgjithshme përdoren për të thyer akullin. Ato janë një mundësi e mirë për ju, që të shfaqni kualifikimet, prirjet, përvojën e punës suaj dhe formimin arsimor që ka



lidhje me pozicionin për të cilin po aplikoni. Shiteni veten dhe tregoni se jeni personi i duhur për punën.

Pyetjet e sjelljes janë të bazuara në supozimin se sjelljet e kaluara janë një parashikues i mirë për sjelljet në të ardhmen. Pyetje të tilla kërkojnë që ju të përshkruani një situatë në të cilën tregoni një cilësi të veçantë ose një aftësi që është e nevojshme për postin e punës.

Pyetjet rrethore ose të situatës janë të hartuara për të parë se si do të reagonit në një mjedis pune. Këto pyetje në përgjithësi kanë të bëjnë me situata të vështira për të cilat ju duhet të gjeni një zgjidhje të kënaqshme.

Kandidatët zakonisht janë të mirëpritur për të bërë pyetje në fund të intervistës; kjo është arsyeja pse duhet të përgatisni pyetje për intervistuesit. Këto pyetje do t'ju mundësojnë të qartësoni aspekte të caktuara rreth pozicionit dhe kompanisë, duke u qartësuar më tepër për interesin që keni për këtë pozicion.

#### 5.4.2 Gjatë intervistës

Përshtypja e parë është shumë e rëndësishme. Mos harroni që gjuha e trupit është po aq e rëndësishme sa ajo çka ju shprehni me gojë.

- Respektoni orarin, mbërrini 10-15 minuta përpara orarit.
- Vishuni në mënyrë profesionale.
- Mos hidhni parfum me erë të rëndë.
- Kurrë nuk duhet të përtpni çamçakëz ose karamеле.
- Përhëndeteni intervistuesin me kontaktin në sy, me një buzëqeshje miqësore dhe me një shtrëngim duarsh.
- Sillni me vete CV-në dhe dosjen tuaj personale të punës për referim të shpejtë.
- Jini pozitivë dhe entuziastë. Shpesh qëndrimi i mirë mund të ketë përparësi në aftësitë dhe përvojën tuaj.
- Qëndroni të fokusuar. Përgjigjuni pyetjeve me saktësi dhe shikoni intervistuesin në sy.
- Gjithmonë mbështesni përgjigjet tuaja me shembuj konkretë që ilustrojnë aftësitë, prirjet dhe përvojën e punës suaj.
- Mund të bëni pyetjet vetëm kur është koha e duhur.
- Përpara largimit, mund të pyesni për hapat e ardhshëm në procesin e rekrutimit dhe të theksoni që do të jeni në pritje të telefonatës së tyre.
- Asnjëherë nuk duhet harruar fjala "Faleminderit" në përfundimin e intervistës bashkë me shtrëngimin e duarve.

#### 5.4.3 Pas intervistës




• Mos hezitoni të pyesni për reagimet pas intervistës. Punëdhënësi mund të bëjë komente të dobishme mbi anët e forta dhe dobësitë tuaja gjatë intervistës. Ky reagim do të jetë i dobishëm për intervistat në të ardhmen.

• Menjëherë pas intervistës, mbani shënime në lidhje me punën, punëdhënësin dhe se si ju u përgjigjët pyetjeve. Reagimi i tyre do të jetë i dobishëm për mundësinë e një interviste të dytë.

• Brenda 24 orëve dërgoni një letër falenderimi.

Letra duhet të përmbajë:



- Falenderoni intervistuesit për kohën e tyre dhe mos harroni të përmendni datën dhe orën e intervistës si dhe pozicionin për të cilin ju kanë intervistuar.
- Përsërisni interesin tuaj për atë pozicion pune.
- Nxirrni në pah përputhjen e kërkesave të punës me aftësitë tuaja.
- Shprehni besimin tuaj që jeni në gjendje për të bërë këtë punë.
- Përfundoni letrën me entuziazëm dhe besim të plotë.
- Nëse ju nuk keni marrë një përgjigje brenda një ose dy javëve, atëherë do të ishte mirë sikur të bënit një telefonatë ose të dërgonit një e-mail.

Çfarë tjetër pas kësaj?

I keni përfunduar kërkimet tuaja dhe e keni gjetur punën që ju intereson? Pika tjetër është të lexoni hapin e fundit të këtij udhëzuesi "Menaxhimi i suksesit tuaj pas fillimit të karrierës". Mos harroni se mund të ktheheni në këtë hap në çdo kohë gjatë karrierës suaj!



**E**ksplorimi dhe përdorimi i strategjive ju ndihmon të keni sukses dhe të lulëzoni në fushën profesionale. Të qenurit të kënaqur dhe të suksesshëm me karrierën tuaj, kërkon investim të vazhdueshëm.

## 6.1 Viti i parë në punë

Viti i parë në detyrë shpeshherë është i vështirë, por krijohet edhe mundësia për t'u integruar dhe për të bërë emër për veten tuaj. Më poshtë paraqiten disa strategji të rëndësishme që ju sigurojnë, që viti i parë në punë të jetë sa më i kënaqshëm dhe produktiv.

### 6.1.1 Njihuni me kulturën e kompanisë

Çdo profesion, organizatë ose ndërmarrje ka karakteristika të saj të veçanta si: strukturën organizative, stilin e menaxhimit, politikat, procedurat, gjuhën teknike, si dhe mjetet e punës që përcaktojnë kulturën e përgjithshme të saj. Për t'u përshtatur me mjedisin e kompanisë, ju duhet:

- të jeni të vetëdijshëm për politikat dhe procedurat e kompanisë dhe t'i ndiqni ato.
- të mësoni gjuhën profesionale, sidomos kur puna është teknike ose akademike, në mënyrë që të komunikoni me kolegët me efikasitet.
- të përqëndroheni për të mësuar dhe për t'u bërë të aftë në përdorimin e ndonjë pajisjeje të re apo mjeti me të cilin nuk jeni të familjarizuar.

### 6.1.2 Dëgjoni sa më shumë

Jepni kontributin tuaj kur keni mundësi, shprehni idetë dhe vërejtjet tuaja, por sigurohuni që i dëgjoni kolegët dhe eprorët tuaj, të cilët kanë mjaft informacion dhe këshilla të vlefshme për ju.

### 6.1.3 Kërkoni sugjerime

Mënyra më e mirë për të mësuar është nëpërmjet sugjerimeve. Nëse nuk jeni duke marrë ndonjë reagim apo koment në lidhje me punën tuaj, pyesni kolegët apo supervisorët tuaj për sugjerime të drejtpërdrejta.

### 6.1.4 Tregoni iniciativë

Nëse ju jeni vullnetarë për projekte, duhet të jeni të etur, entuziastë dhe kompetentë.

### 6.1.5 Krijoni marrëdhënie të mira në punë

Ndërtoni marrëdhënie të mira në punë me bashkëpunëtorët e suksesshëm dhe të besueshëm. Duhet të jeni gjithmonë profesionistë dhe të shmangni thashethemet që pa dashje ofendojnë kolegët tuaj.

### 6.1.6 Rrjeti

Ndërtoni dhe mbani marrëdhënie të forta profesionale. Ky është një investim i vërtetë, sepse njerëzit mund të jenë një referencë e rëndësishme për ju në të ardhmen. Prandaj mos e nënvlerësoni rëndësinë e lënies së një përshtypjeje sa më të mirë tek këta profesionistë.

### 6.1.7 Jini të durueshëm

Rehatia në punën tuaj të re mund të zgjasë deri në një vit. Krenohuni me hapat e vegjël, mbani objektivat tuaja në mendje dhe përpiquni gjithmonë për më të mirën tuaj. Shkurt, argëtohuni duke mësuar.

## 6.2 Mirëqenia në vendin e punës

Mirëqenia juaj fizike dhe psikologjike në punë është pika kryesore e zhvillimit të karrierës suaj. Pakënaqësia dhe stresi i zgjatur në punë ju çojnë në probleme shëndetësore. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që të bëni çdo gjë për të siguruar mirëqenien tuaj në vendin e punës. Kjo është një përgjegjësi e përbashkët midis të punësuarve dhe punëdhënësve, të cilët mund të mbështesin përpjekjet tuaja dhe të ofrojnë shërbime të veçanta sipas nevojës tuaj.

### a. Balanconi punën dhe jetën tuaj personale

Arritja e një ekuilibri midis punës dhe jetës suaj personale mund të jetë e vështirë dhe ndryshon nga një person në tjetrin. Prandaj kjo është unike dhe varet nga ju për të krijuar një ekuilibër të tillë dhe për ta ruajtur atë respektoni prioritetet dhe vlerat tuaja.

### b. Menaxhimi i kohës në punë

Kur koha juaj është shumë e shkurtër për të bërë çdo gjë, ju mund të ndihenisikur jeni të zhytur plotësisht dhe duket sikur po humbisni kontrollin. Organizimi i kohës suaj dhe ngarkesa në punë tregon mënyrën e menaxhimit të kërkesave të punës nga kolegët dhe eprorët tuaj si dhe ndarjen apo delegimin e punës kur ajo mund të ndahet midis anëtarëve të ekipit. Për të pasur efikasitetin optimal të punës është e rëndësishme të shmangni zvarritjet dhe të qëndroni të motivuar dhe të përqëndruar për detyrat në të ardhmen.

### c. Mos harroni bazat

Pasi keni punuar pa ndërprerje, performanca juaj në punë



bie, por përfiton të rimarrë energjitë e humbura kur bëni pushime të shkurtra apo pushim dreke. Pushimi ju ndihmon të ndaloni dhe të plotësoni nivelin e energjisë së humbur për t'u bërë sërish produktiv. Prandaj ju sugjerojmë që të personalizoni hapësirën e punës suaj në mënyrë që ajo të jetë sa më e rehatshme dhe e këndshme duke ruajtur këshu marrëdhëniet dhe lidhjet tuaja sociale. Por mbi të gjitha, sigurohuni të flini mirë, të hani në mënyrë të shëndetshme si dhe të caktoni një kohë për stërvitje dhe argëtim.

### 6.3 Kënaqësia e punës

Puna ideale është ajo në të cilën ndiheni të motivuar, të frymëzuar, të respektuar dhe të paguar mirë. Megjithatë, ka raste kur mund të ndiheni të pakënaqur dhe të zhgënjyer me punën tuaj nga elemente të tilla si:

- Konfliktet me bashkëpunëtorët ose me mbikëqyrësit tuaj.
- Pagë e ulët për punën që bëni.
- Mungesa e pajisjeve ose e burimeve të nevojshme për ta bërë mirë punën tuaj.
- Mungesa e mundësive për avancim të mëtejshëm në punë.
- Mungesë kontrolli apo përfshirjeje në vendimmarrje që ju prek edhe ju.
- Frika për sigurinë e punës.

Më poshtë paraqiten disa pika që duhet t'i merrni në konsideratë për të tejkaluar pakënaqësitë në punë.



#### 6.3.1 Tregoni mënyrën tuaj të punës

Njerëzit kanë tendencë për ta parë punën në tre këndvështrime: si punë, si karrierë, ose si thirrje.

Nëse ju e shikoni punën thjesht si një vend pune të nevojshëm, atëherë fokusi juaj kryesor është shpërblimi financiar afatshkurtër. Megjithatë, nëse ju e perceptoni punën tuaj si një karrierë, shqetësimi juaj kryesor është ecja përpara si dhe fitimet personale dhe financiare që vijnë me ngjithjen e shkallëve në karrierë. Dhe së treti, puna në vetvete është një burim vitaliteti dhe zhvillimi.

Nëse aspiratat e karrierës suaj ndryshojnë, ju do të ndryshoni edhe mënyrën sesi e kuptoni dhe kryeni punën tuaj aktuale, kështu që menjëherë do të filloni të kërkoni punë tjetër.

#### 6.3.2 Sfidoni veten

Nëse puna juaj nuk është sfiduese, ajo nuk do të jetë interesante dhe stimuluese për ju. Për të shmangur këtë, zgjeroni aftësitë tuaja në punë ose merrni përsipër të kryeni një projekt përtej detyrave tuaj të caktuara, që të keni një qëllim motivues.

#### 6.3.3 Tregohuni pozitivë

Në rast se mendoni se jeni gjithmonë duke bërë komente negative për punën tuaj, atëherë provoni të ndryshoni duke i parë gjërat në perspektivë. Mos harroni se pengesat janë një mundësi e mirë për të kuptuar dhe provuar vlerat dhe aftësitë tuaja, pasi gabimet dhe dështimet ju bëjnë punonjësin më të zotë dhe më të shkathët. Përqëndrohuni në aspektet pozitive të punës tuaj.

Megjithë përpjekjet për të përmirësuar kënaqësinë në punën tuaj, nganjëherë ajo punë thjesht nuk është e duhura për ju. Në këtë rast, ju duhet të jeni të gatshëm për një punë tjetër apo për karrierë të re.

#### 6.3.4 Ndryshim në karrierë?

Nëse mendoni se karriera që keni zgjedhur është më e duhura për ju, atëherë jeni duke u përballur me një vendim të rëndësishëm në jetën tuaj. Më poshtë është një proces me dhjetë pika, i cili do t'ju ndihmojë për të gjykuar mbi nevojën e ndryshimit të karrierës suaj dhe si ta planifikoni atë.

Pika 1: Zgjidhni çfarë ju pëlqen dhe çfarë jo  
Kthehuni prapa në hapin e parë të këtij udhëzuesi "Njohja e vetvetes". Është koha për të rizbuluar veten tuaj duke rivlerësuar aftësitë, interesat, vlerat dhe përvojën e punës suaj.

Pika 2: Kërkoni karriera të reja.  
Kthehuni prapa në hapin e dytë të këtij udhëzuesi "Konsideroni mundësitë tuaja". Bëni kërkime të mëtejshme për karrierën tuaj duke pasur parasysh pasionet dhe interesat tuaja. Nëse jeni duke marrë parasysh një ndryshim të madh, duhet të përgatiteni për të bërë kërkime të thella.

Pika 3: Aftësi punësimi  
Përpikuni të kuptoni se si aftësitë dhe përvoja e punës aktuale do të mund të përshtaten me karrierën tuaj të re. Ju mund të habiteni se sa shumë përvoja juaj e punës së kaluar mund të jetë urë lidhëse me karrierën e re, sidomos kur ju mund të mbështeteni në aftësitë tuaja komunikuese, planifikuese, drejtuese dhe menaxhuese të përfituara më parë.

Pika 4: Edukimi dhe trajnimi profesional  
Informohuni për një apo dy kurse për të kuptuar se fusha që keni zgjedhur ju ngjall interes. Gjeni se çfarë kualifikimesh, njohurish dhe cilësish personale apo profesionale kërkohen në këtë fushë të re dhe se cilat kurse, shkolla, universitete kanë programin më të mirë për studime në atë fushë. Nëse aftësitë që doni të fitoni mund të jenë të

dobishme në pozicionin tuaj aktual, përpikuni që punëdhënësi juaj të paguajë për trajnimin tuaj.

**Pika 5: Rrjeti i kontakteve**

Kontaktoni njerëzit ekzistues në rrjetin tuaj. Ata mund t'ju ofrojnë këshilla të çmueshme, udhëzime për punë apo mund t'ju pasurojnë me kontakte të reja të cilat mund t'ju ndihmojnë për kërkimin e punës suaj të re. Merrni në konsideratë kolegët, miqtë, anëtarët e familjes, ish-studentë të universitetit tuaj, si dhe organizatat profesionale në fushën tuaj të re.

**Pika 6: Fitimi i përvojës profesionale**

Provoni një punë part-time ose kryeni punë vullnetare për të fituar një përvojë të re dhe për të krijuar një ide, se cila është në të vërtetë fusha që ju intereson më shumë për të punuar apo nisur karrierën tuaj. Gjithashtu mund të punoni në dy punë njëkohësisht nëse keni kohë, me qëllim që të përfitoni përvojën e kërkuar.

**Pika 7: Gjetja e një këshilltari**

Kalimi nga një karrierë në një tjetër mund të jetë një proces shkurajues dhe dërrmues, veçanërisht në rastet kur ndiheni të vetmuar në këtë proces. Një këshilltar i ri në fushën tuaj të punës mund t'ju ndihmojë të largoni presionin dhe mund t'ju ofrojë gjithashtu këshilla strategjike dhe mbështetje, si dhe zgjerimin e rrjetit tuaj të kontakteve.

**Pika 8: Ndryshimi i karrierës jashtë dhe brenda vendit**

Falë lëvizjes paralele brenda organizatës apo së njëjtës kompani, është e mundur të ndryshoni karrierë pa ndryshuar punëdhënësin. Kjo lëvizje ju jep mundësinë të fitoni ekspertizën e duhur si dhe të zgjeroni kontaktet tuaja brenda kompanisë. Gjithashtu mund t'ju bëjë një kandidat shumë më tërheqës për një promovim në të ardhmen.

**Pika 9: Bazat e kërkimit të punës**

Shkoni përsëri në hapin e pestë të këtij udhëzuesi "Planifikimi i kërkimit të punës tuaj". Bëni kërkime rreth kompanive dhe pozicioneve që ju interesojnë dhe përgatitni një CV cilësore dhe një letër motivimi duke shqyrtuar me kujdes edhe teknikat e intervistimit që ju paraqiten në hapin e pestë të këtij udhëzuesi (pika 5.4).

**Pika 10: Fleksibiliteti**

Ndryshimi i karrierës mund të sjellë ndryshime të tjera të rëndësishme si vendodhjen e punës suaj, pagën dhe sigurinë në punë. Mundohuni të jeni sa më fleksibël dhe të përgatitur për disa pengesa dhe dështime të mundshme.

## 6.4 Shoqatat profesionale, konferencat

Shoqatat profesionale janë zakonisht grupe jofitimprurëse që ekzistojnë për të ndihmuar njerëzit që punojnë në një profesion të veçantë, si dhe interesat publike dhe profesionale të tyre. Për këtë arsye bashkimi me një shoqatë profesionale është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar

rrjetin tuaj me profesionistë të kësaj fushe, me të cilët të mund të ndani interesat tuaja. Në fakt, rrjetet e kontakteve, certifikimet dhe arsimimi i vazhdueshëm përbëjnë qëllimin kryesor të të gjitha shoqatave profesionale.

Cilado të jetë fusha e punës suaj, ju do të keni mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në konferenca, me qëllim që të shkëmbeni idetë dhe përvojën tuaj, të hapni diskutime dhe debate, si dhe të sillni ndryshime në këtë profesion. Përveç faktit të një mundësie për të mësuar, konferencat janë gjithashtu një shans i mirë për të zgjeruar rrjetin e kontakteve me ekspertët e fushës tuaj.

## 6.5 Zhvillimi profesional i vazhdueshëm

Bota e punës është vazhdimisht në ndryshim, kështu që çfarëdo profesion të zgjidhni nuk duhet të harroni që të mësuarit gjatë gjithë jetës është i domosdoshëm. Ky angazhim për vetëpërmirësimin tuaj do t'ju japë mundësinë për të zgjeruar aftësitë dhe njohuritë tuaja, si dhe do t'ju bëjë të njohur me tendencat e reja profesionale. Ju do të keni kështu mundësi të mëdha për ecjen përpara në karrierën tuaj.



*DM Consulting Services ka përgatitur këtë udhëzues si një burim informacioni për njohjen dhe hyrjen në tregun e punës në Shqipëri. Edhe pse i destinuar kryesisht për studentët, ky udhëzues mund të jetë i dobishëm për të gjithë.*

